



# KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

## BE QENDRA E KUVENDIT

### BE LAJME maj 2018

BEQ-numër 34/2018



### SAMITI BE-BALLKANI PERËNDIMOR: PËRMIRËSIMI I LIDHSHMËRISË DHE SIGURISË NË RAJON



Më 17 maj 2018 në Sofje u mbajt Samiti midis liderëve të Bashkimit Evropian dhe partnerëve nga Ballkani Perëndimor, ku u konfirmua perspektiva evropiane e rajonit dhe u bënë veprime konkrete për të forcuar bashkëpunimin në fushat e lidhjes, sigurisë dhe sundimit të të drejtës.

Samiti dhe Deklarata e Sofjes theksuan rëndësinë e angazhimit të vazhdueshëm të Ballkanit Perëndimor drejt sundimit të së drejtës, luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, qeverisjes e mirë dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe të të drejtave të personave që u përkasin minoriteteve.

Zbatimi efektiv i reformave në këto fusha është vendimtar për përparimin e mëtejshëm në rajon përgjatë rrugës evropiane.

Udhëheqësit e BE dhe të Ballkanit Perëndimor ranë dakord të ndërmarrin aktivitete për të përmirësuar infrastrukturën e energjisë dhe të transportit dhe lidhjen digjitale në rajon.

Në mbështetje të zbatimit të Deklaratës së Sofjes, dhe në bazë të Strategjisë për Ballkanin Perëndimor të Komisionit Evropian dhe gjashtë iniciativat udhëheqëse, Presidenti Juncker njoftoi në Samit një paketë të re masash që do të forcojnë lidhjen në rajon dhe me BE-në, veçanërisht nëpërmjet komizës investuese për Ballkanin Perëndimor.

• BE do të ofrojë grante për 11 projekte të tjera me përparësi të lartë (rrugë, hekurudha, limane) prej 190 milion euro.

• Me qëllim të zhvillimit të Agjendës së re digjitale për Ballkanin Perëndimor, BE dedikoi 30 milion euro për investime në rrjetet e brezit të gjerë në gjithë rajonin.

• BE do të mbështesë tranzicionin e energjisë në rajon duke promovuar energjinë e rinovueshme, duke përfshirë përdorimin e qëndrueshëm të hidrocentraleve.

• Në fushën e lidhjes ekonomike, Komisioni vazhdon të mbështesë planin e saj të rajonit për zhvillimin e Sferës Ekonomike Rajonale.

• Komisioni do të rrisë mbështetjen për të rinjtë dhe arsimin, në veçanti duke dyfishuar fondet për Erasmus + për rajonin dhe duke filluar projekt pilot për mobilitet në arsimin dhe trajnimin profesional.

Në Samitin, liderët e BE-së dhe të Ballkanit Perëndimor ranë dakord ta intensifikojnë bashkëpunimin e përbashkët mbi prioritetet kryesore të sigurisë:

• lufta kundër terrorizmit, duke përfshirë financimin e saj, ekstremizmin e dhunshëm dhe kthimin e luftëtarëve të huaj dhe parandalimin e radikalizimit;

• bashkëpunim i shtuar në luftën kundër krimit serioz dhe të organizuar, posaçërisht për posedimin ilegal të armëve të zjarrit dhe trafikut të drogës, kontrabandimin e mallrave dhe personave, si dhe kërcënimeve kibernetike dhe hibride.

• përmirësimi i bashkëpunimit strategjik dhe operativ në sferën e gjyqësisë dhe policinë përmes pjesëmarrjes së Ballkanit Perëndimor në ciklin politik evropian 2018-2021 - bashkëpunim i koordinuar në nivel të BE-së kundër krimit të rëndë dhe të organizuar.

Udhëheqësit e BE dhe të Ballkanit Perëndimor ranë dakord të rritin bashkëpunimin mbi migracionin dhe menaxhimin e kufijve, duke përfshirë edhe përmes oficerëve për lidhje të caktuar nga BE-ja.

Samiti i ardhshëm BE-Ballkani Perëndimor do të mbahet gjatë kryesimit Kroat me Këshillim e BE

<http://www.consilium.europa.eu>



#### Përmbajtja e lajmeve:

Samiti UE-Ballkani Perëndimor: përmirësimi i lidhshmërisë dhe sigurisë në rajon	1
Në fokus të Parlamentit Evropian	2-3
Aktivitete të kuvendit të lidhura me çështjet evropiane	4-5
Poloni-protestat të nënave të fëmijëve me aftësi të veçanta	6
Zvogëlimi i buxhetit për Politikë të përbashkët të bujqësisë të papranueshme për Francë	7
2018 - Vit evropian të trashëgimisë kulturore	8
Deputetët në Poloni i zvogëluar rrogat e tyre për 20%	9
Import i zmadhuar i UE-së nga vendet të Ballkanit Perëndimor	10
Analizë e Komisionit Evropian për besimin e qytetarëve në gjyqësi	10
Kroacia planifikon të hyjë në eurozonë për 5 deri në 7 vjet	11
UE kalendar / qershor 2018	11

## NË FOKUS E PARLAMENTIT EVROPIAN



<http://www.europarl.europa.eu>

### Seanca Plenare 2-3 Maj 2018

Shumica e deputetëve në seancën plenare në fillim të majit përshëndetën planin e Komisionit Evropian për të rritur kontributet nacionale në 1.11% të PKB-së dhe për të futur burime të reja të të ardhurave për buxhetin e ardhshëm afatgjatë të BE. Shumica dërrmuese e deputetëve të evropës përshëndetën planet për futjen e resurseve të reja personale për BE-në, bazuar në skemën e re të tatarimeve korporatave, emetimet nga sistemi i tregtimit të emisioneve e kështu me radhë. tatum plastik për zvogëlimin në kontributet direkte nga vendet -anëtare.

Parlamenti Evropian paraqiti pikëpamjet e tij mbi kuadrin financiar shumëvjeçar të BE-së dhe burimet e veta më 14 mars, në dy rezoluta mbi "Përgatitjen e qëndrimit të Parlamentit mbi MFF pas 2020" dhe "Reformimi i Sistemit Evropian të resurse personale".

Sipas rezolutës së miratuar të Parlamentit Evropian, fëmijët nuk do të ndalohen për arsye imigrimi dhe Komisioni Evropian duhet të veprojë kundër vendeve- anëtare të BE-së në rastet e mbajtjes së vazhdueshme dhe sistematike të fëmijëve dhe familjeve të tyre. Parlamenti Evropian u kërkon autoriteteve nacionale të shpejtojnë procedurat për emërimin e kujdestarëve për fëmijët e pashoqëruar të cilët gjithashtu duhet të vendosen në objekte të veçanta nga të rriturit në mënyrë që të shmangin rrezikun e dhunës dhe abuzimit seksual.

Deputetët evropianë kërkuar zhvendosjen e fëmijëve të pashoqëruar të mbetur nga Greqia dhe Italia, si një prioritet dhe të gjitha procedurat e ribashkimit familjar vazhdojnë pa vonesë. gjithashtu u shpreh shqetësim i veçantë në lidhje me shfrytëzimin e vajzave dhe u kërkoi vendeve anëtare të rritin përpjekjet dhe bashkëpunimin ndërkufitar për të identifikuar fëmijët viktimë të trafikimit, abuzimit dhe të gjitha formave të shfrytëzimit.

Në rezolutën, e hartuar nga Barbara Spinelli, deputet evropian nga Italia, i cili u miratua me 488 vota për, 43 kundër dhe 114 abstenime, vihet re se shtetet anëtare të BE-së "duhet të krijojnë dhe mbajnë ligjërish dhe në praktikë,

mjedis të sigurt për gazetarët. Deputetët i kërkoi Komisionit Evropian të japë financim të përhershëm dhe të mjaftueshme nga buxheti i BE-së për të mbështetur monitorimin e pluralizmit të mediave në Qendrën për pluralizmin e medias dhe lirinë e mediave si dhe të krijojë mekanizëm të pavarur për monitorim dhe vlerësim rreziqet për pluralizmin e medias dhe lirinë në BE. Eurodeputetët në diskutim thek-

suan qëndrimet dhe udhëzime e tyre për të përmirësuar ekzaminimin e rregullt të lirisë së shprehjes, ngacmimet në internet, hakmarrje, pornografinë dhe abuzimit seksual të fëmijëve, si dhe lehtësimin e verifikimit e fakteve në fushën e "informacionit të rremë".

Parlamenti Evropian bëri thirrje për përfundim të menjëhershëm të zgjedhjeve të parakohshme presidenciale të Venezuelës, të planifikuar për në 20 maj 2018, me rezolutë të miratuar nga 492 vota për, 87 kundër dhe 77 abstenime. Bashkimi Evropian do të njohë zgjedhjet që bazohen vetëm në kalendar të qëndrueshëm zgjedhor, të miratuar në kontekstin e dialogut nacional me të gjithë faktorë relevantë dhe partitë politike dhe respektimin e kushteve të barabarta, të drejta dhe transparente për pjesëmarrje.

Parlamenti Evropian ka bërë thirrje për rrugë diplomatike për ndalim të gjërë për testimin e kozmetikës së kafshëve para vitit 2023. Në BE, shitja e të gjitha produkteve kozmetike të testuara në kafshë është ndaluar që nga viti 2013. Deputetët u bëjnë thirrje liderëve të BE-së të përdorin rrjetet e tyre diplomatike për të ndërtuar koalicion dhe për të nisur konventë ndërkombëtare brenda OKB-së për të futur një ndalim global në testimin e kafshëve për kozmetikë dhe tregtinë në përbërësit kozmetikë të testuar për kafshët. Ndalimi duhet të krijohet para vitit 2023.

## NË FOKUSIN E PARLAMENTIT EVROPIAN

### Sesioni plenar 28-31 maj 2018

Eurodeputetët i mbështetën planet për vendosjen e mekanizmit për skringing të investimeve të huaja direkte (IHD) në mënyrë transparente, të parashikueshme dhe jodiskriminuese. Qëllimi është që të sigurohet që investimet e huaja nuk paraqesin kërcënim për infrastrukturën kritike, teknologjitë kyçe ose qasja në informata të ndjeshme. Propozimi i ri, do t'i mundësojë vendeve anëtare edhe Komisionit të kontrollojnë:

- Nëse investimi i huaja mund të ndikojë në pavarësinë e medieve ose të autonomisë strategjike të BE,
- Nëse investitori ka ndikim për investimin e projekt të cilat mund ta rrezikojnë sigurinë ose rendin publik, ose
- Investimi mund të sjellë deri në krijimin e monopolit.

Në moment vetëm në 12 nga 28-të vende anëtare ekziston skringing-mekanizmi i cili i hulumton IHD në bazë të sigurisë ose rendit publik. Sistemet dallohen shumë, kurse vendet nuk i koordinojnë qasjet e tyre, edhe kur investimet mund të kenë efekt në më shumë vende. Propozimi nuk kërkon harmonizim të mekanizmit nacional për skringing, por përmirësimin e bashkëpunimit mes vendeve anëtare dhe Komisionit. Kjo reformë është pjesë e pakos tregtare dhe investuese publikuar nga Komisioni në shtator 2017.

Plani i dytë shumëvjeçar për peshkim në suaza të politikës të përbashkët për peshkim (CFP) - i miratua me 520 vota për, 131 kundër dhe 9 të përmbajtur. Plani i ri do ta rregullojë menaxhimin me peshkim për llojet dementerë ( që jetojnë në afërsi të fundit të detit), të cilat paraqesin 70% nga peshkimi në detin Verior. Me rregullat e reja:

- Përcaktohet përfshirja ( minimum-maksimum) në suaza të cilës ministrat e BE mund t'i vendosin peshkimet e lejuara të përgjithshme vjetore ( TACs) dhe kuota,
- Lejohet marrja e shpejtë e provave të reja shkencore gjatë përcaktimit të kuotave,
- Suspendohet dhe/ose ulet peshkimi për mall të caktuar kur këshillat shkencor sugjerojnë për rrezikun e rezervave, dhe
- Bazohen të gjitha masat të " këshilla

shkencor të arritshëm më të mirë".

Rregullativa do të hyjë në fuqi ditën e njëzetë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të BE.

Parlamenti Evropian ka miratuar rregulla të reja të rishikuara, me 456 vota për, 147 kundër dhe 49, të përmbajtur, të cilët kanë për qëllim të sigurojnë mbrojtje më të mirë për punëtorët me punë të përkohshme në vend tjetër të BE dhe konkurrencë të ndershme për kompanitë. Sipas tekstit të dakorduar, të gjitha rregullat për shpërblimin e vendit- nikoqir duhet të zbatohen edhe për këta punëtorë. Deri tani kjo ishte rast vetëm në sektorin ndërtimor. Vendet anëtare kanë dy vite t'i transponojnë rregullat në ligjet e tyre nacionale dhe duhet t'i vënë në fuqi deri në fund të kësaj periudhe.

Parlamenti Evropian miratoi ndihmë për përkrahje të rekonstruimit në Greqi, Spanjë, Francë dhe Portugali, pas katastrofave natyrore të cilat ndodhën në vitin 2017. Shuma e miratuar e mjeteve në lartësi prej 104,2 milion euro vjen nga Fondi Evropian Solidar. Ndihma përfshin 50,6 milion euro për rekonstruim në rajonin Portugez Cenro pas zjarreve të shumta në pyje në qershor dhe tetor 2017, dhe 3,2 miliona euro për Spanjën për sanimin e dëmeve në rajonin fqinjë Galicija.

Franca do të marrë 49 milion euro për dëmin nga uragani Irma dhe Maria në territoret tej oqeanike franceze të Sent Martin dhe Gvadalupe në shtator 2017. Greqia do të marrë 1.3 milion euro për rregullimin e shtëpive, bizneseve dhe infrastruktura si pasojë e tërmeteve në Lezbos nga qershori 2017.



## AKTIVITETE TË KUVENDIT LIDHUR ME ÇËSHTJET EVROPIANE



Delegacioni i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë në përbërje: z. Ilija Nikollovski dhe z. Ivan Stoilkoviç, morën pjesë në Seminarin rajonal për Qëllime të qëndrueshme zhvillimore, për parlamentet e Evropës lindor dhe qendrore, në organizim të Kuvendit Popullor të Republikës së Serbisë dhe Unionit Interparlamentar. Seminari mbahet në Beograd më 24 dhe 25 maj, 2018.

[www.sobranie.mk](http://www.sobranie.mk)



Në hapjen e seminarit morën pjesë edhe Kryetari i Kuvendit, z. Talat Xhaferi, i cili njëkohësisht, ishte për vizitë kthyesë në Republikën e Serbisë. Vizitën e vet Kryetari i Kuvendit e filloi në takim me nikoqiren e tij, znj. Maja Gojoviç të Kuvendit Popullor të Republikës së Serbisë. z. Xhaferi u përqendrua në aktivitetet aktuale dhe rekomandimin e marrë pa kusht nga Komisioni Evropian për fillimin e negociatave për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë në BE. Zonja Gojoviç, theksoi se vizita e Kryetarit Xhaferi jep porosi të qartë për rajonin dhe BE-në se Republika e Serbisë dhe Republika e Maqedonisë bashkëpunojnë dhe shprehin gatishmëri që të ndahen përvojat në nivel të komisioneve dhe shërbimeve mes dy parlamenteve. Në kuadër të vizitës zyrtare në Republikën e Serbisë, Kryetari i Kuvendit u takua edhe me kryetaren e Qeverisë së Republikës së Serbisë, znj. Ana Bërnabiq. Në takim, konstatimi i përbashkët ishte se zhvillimi i marrëdhënieve bilaterale, bashkëpunimi rajonal dhe multilateral lëviz në drejtim përpjetë dhe se ka intensifikim të vizitave të ndërsjella. Zotëri Xhaferi e përshëndeti formimin e këshillit të përbashkët Maqedonas-Serb të odave ekonomike të dy vendeve dhe tha se çdo mundësi e cila kontribuon drejt zhvillimit të bashkëpunimit të nivelit bilateral dhe rajonal, do të përkrahjet. Kryetari i Kuvendit ka realizuar takim me prof. Vlladimir Marinkoviç, kryetar i Kuvendit Popullor të R. Serbisë dhe kryetarja e Unionit Interparlamentar, znj. Gabriella Kuevas Baron. Vizitën e tij zyrtare z. Xhaferi e rrumbullakoi me vizitën në Komunën e Preshevës ku u prit nga Kryetari i Komunës së Preshevës, Shqipërim Arifi dhe kryetarin e Këshillit Komunal, Sami Salihu.



Më 17 maj 2018, kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, z. Talat Xhaferi, organizoi takim në nder të kryeministres së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore, znj. Tereza Mej.

"Jemi të përkushtuar në kthimin e rolit të vërtetë të institucionit ligjvënës dhe duket se jemi në rrugën e vërtetë, duke gjykuar sipas asaj që raporti për Republikën e Maqedonisë nga Komisioni Evropian ishte pozitiv dhe pa kusht. Do të vazhdojmë në atë rrugë, për qytetarët tanë, fëmijët tanë, gjeneratat e ardhshme, Republika e Maqedonisë dhe të gjithë që ndajmë vlera dhe standarde evropiane", tha z. Xhaferi. Znj. Mej theksoi se sinqerisht është e nderuar nga pranimi që Kryetari Xhaferi e organizoi për nder të saj dhe tha se parlamentet e suksesshme kanë dy punë të përbashkëta: e para, se ato janë vende ku qytetarët kanë qasje të lirë deri tek përfaqësuesit e vet dhe e dyta se çfarë pune kryhet në emër të tyre; e dyta se parlamentet duhet të jenë vende ku deputetët janë në pozitë dhe janë të lirë ta sfidojnë Qeverinë dhe institucionet tjera publike me çështje për aktivitetet dhe politikatat e tyre.



Më 03 maj 2018, në Kuvend u nënshkrua Memorandum për bashkëpunim me Kuvendit dhe Qendrës së Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura, për bashkëpunim për zbatimin e Projektit, "Zhvillim të mbikëqyrjes parlamentare dhe të pavarur" (2017-2020).

## AKTIVITETE KUVENDORE NË LIDHJE ME ÇËSHTJET EVROPIANE

I pari *Zhan Mone Dialog* me Kuvendin u mbajt në Ohër më 17 dhe 18 maj. Pas dialogut joformal dhe të hapur dyditor, partitë politike edhe një herë kanë konfirmuar konsensusin për të punuar bashkërisht për vendin të përparojë drejtë anëtarësisë në BE dhe të integrohet në strukturat Euro-Atlantike.

Me qëllim të përshpejtohet ky proces, partitë politike janë përpjekur Kuvendi të ketë rolin më efikas nëpërmjet shfrytëzimit të plotë të legjitimitetit të vet demokratik, pushtetin mbikëqyrës dhe ligjvënës dhe nëpërmjet inicimit të një sërë reformash duke filluar me përkushtim urgjent në drejtim miratimit të Kodit Etik të ri dhe aplikimit të ndryshimeve urgjente të Rregullores. Gjithashtu është votuar përkushtim ndaj revizionit më vëllimor të Rregullores për t'u siguruar që Kuvendi të jetë më efikas, transparent dhe efektiv gjatë plotësimit të pritjeve të qytetarëve për anëtarësim në BE.

Me qëllim të mbahet momentum i reformave të debatuar kryesore, kryetari Xhaferi paralajmëroi formim të Grupit punues në Kuvend, të formuar nga përfaqësues të partive kryesore politike, për t'u mbështetur implementimi i agjendës reformuese dhe hapat e ardhshëm të procesit Zhan Mone.

Dialogu Zhan Mone kontribuon në drejtim të mbështetjes së Maqedonisë në hapat e ardhshëm të progresit të vendit drejt anëtarësimin në BE, veçanërisht duke i përcjell rekomandimet e pakushtëzuara dhe pozitive nga ana e Komisionit Evropian që tani është duke pritur vendimin e Këshillit.



[www.sobranie.mk](http://www.sobranie.mk)

*Komisioni për çështje evropiane* ka mbajtur mbledhje më 16 maj 2018 me temë “*Perspektiva frënge në bazë të ardhmërisë së BE-së*”. Fjalime hyrëse mbajtën kryetari i Komisionit Z. Artan Grubi, ambasadori i Francës në Maqedoni, E.T. Z. Kristian Timonie dhe Z. Iv Bertonçini, kryetar i Lëvizjes Evropiane të Francës dhe nënkryetar i Lëvizjes Evropiane ndërkombëtare. Në mbledhjen, Z. Grubi e theksoi rëndësinë e mbështetjes frënge për zgjerimin e mëtutjeshëm të BE-së me vendet nga Ballkani Perëndimor. Në atë kontekst, informon se vendi mbetet i përkushtuar në realizimin dhe përmbushjen e rezultateve nga BE reformat të cilat Brukseli i kërkon nga ne, para kryesimit të Këshillit të BE-së në qershor. Ambasadori Timonie theksoi se vendet anëtare të BE-se, kurse në ato suaza edhe Franca, dekadën e kaluar janë ballafaquar me një sërë sfidash serioze, për çka si përmbledhje për mobilizimin evropian ishte Bregziti. Republika e Maqedonisë duhet të punojë për BE reformat e nevojshme, ndërkaj në atë kontekst edhe në zgjidhjen e të gjitha çështjeve të hapura me fqinjët. Zotëri Bertonçini, si profesor dhe kryetar i Lëvizjes Evropiane në Francë sugjeroi që ndër të tjerat, arsye për euroskeptizmin në vendin e vet kryesisht ka prej përvojave negative me disa vende anëtare, të cilat janë anëtarësuar të papërgatitura në Bashkimin. Gjithashtu, si arsye i ka përmendur edhe problemet aktuale me migrantët, si dhe terrorizmin radikal, me të cilat përballet shoqëria franceze. Për këtë arsye, Bertonçini sugjeroi në nevojën që Maqedonia të jetë proaktive në zgjidhjen e këtyre problemeve globale evropiane e botërore, me çka do të kishte fituar simpatitë e qytetarëve francez.



Më 10 maj 2018 në Kuvend u mbajt Panel-diskutim për temën “*Roli i etikut parlamentar në zbatimin dhe respektimin e Kodit Etik në parlamentet*”



## POLONI - PROTESTË E NËNAVE TË FËMIJËVE ME AFTËSI TË VEÇANTA



Bashkimi Evropian e paralajmëroi Poloninë se do të pasojnë sanksione nëse Varshava nuk bën „përparim evident“ në kontestin rreth reformave gjyqësore kontroverze. Kjo paraqet krizë e llojit të veçantë politik pas protestës në parlament të 10 nënave të fëmijëve me aftësi të veçanta.

Nënat dhe fëmijët e tyre në karroca invalidësh e vizituan Sejm (Dhomën e Poshtme) në mesin e prillit, me ftesë të një deputeti të opozitës. Në vend të kësaj, në njërin ndër korridoret kanë hapur dyshekë, kanë nxjerrë pllakate të improvizuara dhe kanë filluar të protestojnë.

Kërkesa e nënave të cilat protestuan është pagesa mujore e 500 zlotëve (apo 116€) për rehabilitimin dhe pajisjen mjekësore të fëmijëve të tyre.

Sipas nënave të cilat protestuan, ekonomisë së Polonisë është duke i shkuar puna mirë falë ashpërsimit të sistemit tatimor. Krahas shpenzimit qeveritar të punëve siç janë promovimi i patriotizmit dhe bonueset për ministrat, duhet të ketë mjaft të holla edhe për fëmijët e tyre.

Edhe krahas asaj që protestueset u takuan me Presidentin Andrzej Duda dhe Kryeministrin Mateus Morawiecki, kërkesat e tyre rreth një muaji nuk u respektuan. Si rezultat i kësaj, një pjesë e medieve të cilat e mbështesin qeverinë kanë filluar sulm mbi personat me nevoja të veçanta dhe ata që i mbështesin, në mesin e të cilëve, edhe Vanda Trazik-Stavska, veterania 91-vjeçare e Armatës dhe pjesëmarrëse në Kryengritjen e Varshavës qysh në vitin 1944.

Politikanët e partisë qeveritare PiS në Poloni, theksuan se nënat dhe fëmijët e tyre me aftësi të veçanta që flenë në dyshekë në Sejm duhet të largohen me dhunë.

Kur filloi protesta, mareshali i Sejmit, Marek Kuçinski, shpalli mbylljen e godinës parlamentare që më së shumti ndikoi mbi gazetarët - pasi ka gazetarë

të cilët kanë hyrje të përhershme në Sejm dhe gazetarë të cilët shfrytëzojnë vetëm hyrje të njëhershme.

Kështu, për mediet nuk ishte e mjaftueshme ta ndjekin punën e Parlamentit. Ekspertët të cilët thirren në mbledhjet e komitetit nuk mund të hyjnë në Sejm, duhet të anulohen mbledhjet të rëndësishme, kurse vizitorë nuk u lejuan. Ishte e pasigurt nëse Sejmi do të jetë nikoqir i Parlamentit për fëmijët dhe të rinjtë në Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve (1 qershori), që është praktikë çdo vjet.

Parlamenti i Polonisë ishte rrethuar me barrkada policore dhe pritej shpërndarja e policisë përreth Sejmit, sepse garda e mareshalit e cila e mbron Parlamentin, paradokohe e mori të drejtën të shfrytëzojë armë zjarri, kuaj dhe automjete të blinduara. Kjo nuk është hera e parë që Mareshali Kuçinski të vendos bllokadë të parlamentit.

Diskutimet në komisione u reduktuan në minimum, votat e ekspertëve dhe opozita u injoruan.

Sipas Gazeta Viborca nga EURACTIV, liria e shtypit në Poloni ende është e rrezikuar. Rasti i gazetarit të TVN24, Vojçiç Bojanovski, i cili vitin e kaluar zbuloi se rasti me torturën policore, është njëri ndër shembujt më mbresëlënës për kontrollin e shtetit mbi mediet.

Një grup prindërisht me fëmijët e tyre me aftësi të veçanta, të dielën më 27 maj më tepër se një muaj e lëshuan protestën për ndihmë shtetërore. Kështu, familjet siguruan rritje të pagesave mujore për pengesë gjatë protestës së tyre, por jo aq sa kërkuan.

[www.euractiv.com](http://www.euractiv.com)

## ZVOGËLIMI I BUXHETIT PËR POLITIKËN E PËRBASHKËT BUJQËSORE TË PAPANUESHME PËR FRANCËN

Propozimi i paradokohshëm për shkurtrim të mjeteve financiare nga buxheti i dedikuar për Politikën e përbashkët bujqësore shkakton reagime të ashpra në Francë.

Zvogëlimi i mjeteve u parapa edhe në Propozim-buxhetin e fundit kur ish-kryetari i Francës, Fransoa Olland luftonte fuqishëm që të ruhet një pjesë e rrogave të drejtpërdrejta për ndihmën e bujqve që ishin rrezik në buxhetin për vitin 2014-2020. Tani edhe me buxhetin e ri të Komisionit Evropian për periudhën 2021-2027, përsëri propozohet shkurtrim i mjeteve.

Ministri francez i bujqësisë Stefan Travert, bëri thirrje për lidhje me vendet tjera që të shmanget ulja prej 5% në financimin e politikave bujqësore, siç parashihet në Propozim-buxhetin e BE-së për vitin 2021-2027.

Sipas ministrit të Bujqësisë, Stefan Travert "Është e palejueshme që të zvogëlohet buxheti prej 408 miliardë euro në 364 miliardë euro në kohë kur kërkohet më shumë se bujqit". Travert më 3 maj u takua me kolegun e tij irlandez, Majkëll Sid me ç'rast u bashkëngjiten ministrave spanjollë dhe portugezë të bujqësisë nga Spanja dhe Portugalia, në tentim për të formuar lidhje të shteteve kundër uljes së mjeteve të dedikuara për ndihmë të bujqve.

Shtetet e mëdha bujqësore, si Polonia, Italia, Rumania dhe Bullgaria, në mënyrë potenciale do të mund t'i bashkohen lidhjes e cila është kundër uljes së buxhetit për Politikë të përbashkët bujqësore të BE-së. Por, vendet veriatlantike si dhe Gjermania do të mund të jenë kundër këtij projekti, sepse ato thirrën në renacionalizëm të një pjese të PPB, dhe

ishin për reduktim të buxhetit evropian.

Komisioni evropian, si dhe vendet anëtare të BE-së edhe më herët kërkuan rishqyrtim thelbësor të Politikës së përbashkët bujqësore të BE-së: kufizim të ndihmës për ferma më të mëdha, zhvillim të veglave për sigurim të kulturave të cilat do të mund t'i zvogëlojnë shpenzimet e përgjithshme pa ndikuar mbi të ardhurat e fermerëve.

Lufta për buxhetin për PPB në të cilën u përfshi Franca bart edhe rreziqe politike, në periudhën prej një viti para mbajtjes së zgjedhjeve evropiane.

Vazhdimi i konfliktit për buxhetin e PPB mund ta përforcojë të djathtën ekstreme, me atë që Fronti Nacional i Marin Le Pen do të tentojë t'i shfrytëzojë përfitimet potenciale me qëllim fitimin e vendeve në Parlamentin evropian në Strasburg.

Front Nacional tashmë do të tentojë ta shfrytëzojë vlerën e diskutimit buxhetor, duke thënë se BE-ja ka "anë të favorizuara", duke propozuar ta zvogëlojë buxhetin e PPB dhe t'i kushtëzojë alokacionet e fondeve evropiane për respektim të sundimit të së drejtës, propozim i cili ka të bëjë para së gjithash me Hungarinë dhe Poloninë.

<https://www.euractiv.com>



*"Është e palejueshme të zvogëlohet buxheti nga 408 miliardë në 364 miliardë euro në kohë kur kërkohet më shumë nga bujqit"*



## 2018 - VITI EVROPIAN PËR TRASHËGIMI KLTURORE

**2018**   
**EUROPEAN YEAR  
 OF CULTURAL  
 HERITAGE**  
 #EuropeForCulture

BE vendosi të kremtojë vitin 2018 si vitin Evropian të trashëgimisë kulturore për shkak të simbolikës dhe rëndësisë politike. Qëllimi është të ngrihet vetëdija për historinë dhe vlerat e përbashkëta të Evropës si dhe të përforcohet identiteti evropian. Mijëra iniciativa dhe ngjarje në gjithë Evropën do të sigurojnë mundësi të përfshihen qytetarë nga të gjitha mjediset. Qëllimi është të preket publiku më i gjerë, në veçanti fëmijët dhe të rinjtë, komunitetet lokale dhe njerëzit nga të gjitha mjediset.

Më 23 maj 2018, Komisioni Evropian publikoi 29 projekte kulturore të cilat do t'i financojë dhe të cilat u zgjodhën në konkurs publik me rastin e Vitit Evropian të Trashëgimisë Kulturore.

Buxheti i përgjithshëm prej 5 milion euro do të dedikohet për projekte në kuadër të programit "Evropa kreative" e cila paraqet programin kryesor të BE-së për mbështetjen e sektorëve të kulturës dhe sektorëve kreativ. Me buxhetin prej 1,46 bilion euro për periudhën nga viti 2014 deri në vitin 2020, mbështeten organizata të cilat do të veprojnë në fushën e trashëgimisë kulturore, arteve të aplikuara, artin figurativ, artet inter disiplinore, botim, film, televizionin, muzikë dhe video lojëra, si dhe dhjetëra mijë artistë, profesionistë të kulturës dhe audio - vizual.

Slogani i Viti Evropian të trashëgimisë kulturore është "Trashëgimia jonë, vende ku takohen e kaluara dhe e ardhmja". Projektet gjithsej 29, janë zgjedhur nga 77 aplikime, dhe të njëjtat përfshijnë gamë të gjerë të bashkëpunimeve inovative ndërmjet organizatave nga vende të ndryshme anëtare të BE-së. Këto organizata vijnë nga të paktën tre vende të ndryshme të cilat marrin pjesë në programin "Evropa Kreative".

Projektet e zgjedhura janë të ndryshme: nga prodhimi i veshjeve tradicionale nga rajone të ndryshme, për të cilat përdoren shkathtësi tradicionale për punim, deri te hulumtime të epokës së barokut nëpërmjet muzikës. Një pjesë e projekteve janë: dizajne afatgjata dhe arsimore tu ndihmojnë qytetarëve në informimin për përmendoret e kulturës dhe lokalitetet arkeologjike.

Në shtojcë të rëndësisë së cilësisë së projekteve, kriter i rëndësishëm gjatë seleksionimit të projekteve ka qenë potenciali i tyre të maksimizojnë ndikimin e tyre përmes plotësimit të qëllimeve të përcaktuara në nivel lokal, nacional dhe evropian.

Me financimin nëpërmjet programit Evropa Kreative, artistëve ju mundësohet të punojnë në mbarë Evropën të arrijnë deri te publiku më i ri dhe të zhvillojnë shkathtësi të nevojshme në epokën digjitale. Më 2 maj, Komisioni tani më propozoi të krijojë program të ardhshëm për Evropë Kreative me buxhet prej 1,85 bilion euro.

Në kuadër të programit Evropa Kreative, tre aktivitete specifike i janë kushtuar trashëgimisë kulturore: Ditët e trashëgimisë Evropiane, Shpërblimi i BE-së për trashëgimi kulturore dhe Etiketa për Trashëgimi Evropiane.

Në kontekst të Vitit Evropian të trashëgimisë kulturore më 04.05.2018 në qytetin historik Burgos në Spanjën Veriore u mbajt seminar ku u takuan përfaqësuesit lokal dhe rajonal të vendeve anëtare të BE-së në kuadër të Vitit Evropian të Trashëgimisë kulturore 2018. Nëpërmjet diskutimit u theksua rëndësia e trashëgimisë kulturore dhe financimin e tij në të ardhmen në Evropë. Nga viti 2007 deri në vitin 2013, pothuajse 4,5 miliardë euro iu kushtuan trashëgimisë kulturore evropiane. Mjete financiare rezultojnë nga një sërë politika dhe skema për financimin e BE-së. Gjatë debatit u theksua roli kryesor i pushtetit lokal dhe rajonal në menaxhimin, drejtimin, sigurinë dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

<http://europa.eu/>



## DEPUTETËT NË POLONI I ZVOGËLAN RROGAT E TYRE PËR 20%

Me iniciativën e liderëve të Partisë për Drejtësi dhe Zhvillim (PiS) të Polonisë në Jaroskav Kaçinski, parlamentarët polakë votuan zvogëlim të rrogave në rrogat bazë parlamentare pa përvojë të punës për 20%, ndërsa shuma për shpenzimet mbetet e pandryshuar, pavarësisht bojkotit të opozitës.

Opozita ka akuzuar konservatorët në pushtet për reduktimin e rrogave të deputetëve, me qëllim të fshehet skandali me premitë dhe shpërblime të mëdha për ministrat të cilët u dhanë në vitin e kaluar.

Sipas ligjit të ri, deputetët polakë do të marrin 80% të rrogës, e cila sipas sistematizimit është planifikuar për nënkryetarët e shtetit, ndërsa për shpenzimet ata do të marrin 25% të rrogave të nënsekretarëve të shtetit.

Para zvogëlimit, rroga bazë e deputetëve polakë ishte rreth 2,400 euro dhe 600 euro në muaj, të marra si shumë paushall për shpenzimet.

Për ligjin votuan 240 nga 460 deputet, dy ishin kundër, pesë abstenuan, ndërsa deputetët nga të tre partitë opozitare refuzuan në mënyrë demonstrative të votonin.

Opozita akuzoi Kaçinskin dhe konservatorët në pushtet për uljen e rrogave për deputetët, është për qëllim që të fshehet skandali me premi dhe shpërblime të mëdha që u dhanë në 2017. ministrat e qeverisë konservatore të ish-kryeministrit Beate Shidlo. Sipas gazetës Gazeta, ministrat dhe zëvendësit e tyre në vitin 2017 kanë marrë premi prej shumë më tepër që është paguar ndonjëherë si shpërblim për punën e mirë të qeverisë së mëparshme të Polonisë.

Për shkak të revoltës polake, qeveria ishte prezantuar si modeste dhe në shërbim të qytetarëve dhe njëkohësisht i dha 1.2 milionë euro, partia qeverisëse humbi aq sa 12% të besimit në sondazhet në anketat për disponimin e votuesve.

Lideri konservativ Kaçinski dhe presioni publik detyruan ish-kryeministrin, ministrat dhe zëvendësit e tyre për të dhënë shpërblime për bamirësi.

Në fillim të prillit të këtij viti, kreu i PIS Jaroslav Kaçinski theksoi: "Para zgjedhjeve, thashë se në politikë nuk hyhet për para, por shoqëria pret modestinë". Nëse dikush refuzon të mbështesë ligjin për zvogëlimin e rrogave në parlament, ai e humbi mundësinë për t'u bashkuar me listën e kandidatëve. e humbi shansin për të marrë pjesë në politikë."

Deputetët me votat e partisë në pushtet hodhën poshtë të gjitha ndryshimet e paraqitura në opozitë.



<http://www.euronews.com>

## IMPORT I ZMADHUAR I UE-SË NGA VENDET E BALLKANIT PERENDIMOR



<http://ec.europa.eu>

Agjencia Evropiane për statistikë, Evrostat shpalli se importi i Unionit Evropian nga vendet të Ballkanit Perëndimor është i zmadhuar dyfish në 10 vitet e fundit nga 9 në 20 miliardë euro. Gjithashtu, nivel i zmadhuar shënohet te burimet të atyre vendeve prej 18 miliardë në vitin 2007 në 29 miliardë në vitin 2017. Sipas të dhënave të Eurostat, Maqedonia ka pjesëmarrje më të madhe në eksportin dhe importin e prodhimeve me anëtare të UE-së në tregtinë e përgjithshme.

Vitin e kaluar, Maqedonia merri pjesë me 81% të eksportit të përgjithshëm në vendet të Unionit Evropian, me vlerë prej 4 miliardë euro.

Pas Maqedonisë është Shqipëria, me 1,6 miliardë euro prodhime të cilat eksportohen në vende të Unionit Evropian, të cilat përbëjnë 77% të eksportit të përgjithshëm të atij shteti, ndërsa në vendin e tretë është Bosnja dhe Hercegovina e cila ka eksport prej katër miliardë euro, që është 71% nga eksporti i sajë i përgjithshëm.

Kur është në pyetje importi nga Unioni Evropian Maqedonia është e para në listë me 4,3 miliardë euro, që paraqet 63% nga importi i përgjithshëm.

Më shumë se gjysma e importit i Serbisë përkatësisht 59% rrjedh nga vendet-anëtare të Unionit Evropian, në shumë prej 10,3 miliardë euro. Kosova ka import prej 1,3 miliardë euro prodhime, që paraqet 43% nga importi i përgjithshëm. Mali i Zi ka import prej 1,1

miliardë euro, përkatësisht 47% nga importi i përgjithshëm.

Në vitin 2017, Unioni Evropian realizoi sufit prej nëntë miliardë euro në tregtinë me vende të Ballkanit Perëndimor, që është për 10 përqind më shumë sesa në vitin 2016.

Eksportues më i madh ndërmjet vendeve-anëtare të Unionit Evropian në vendet ballkanike janë Gjermania, me 16% nga importi i përgjithshëm në regjion dhe Italia me pjesëmarrje prej 14%. Prapa tyre janë Sllovenia (10%), Hungaria (9) dhe Kroacia (8).

Gjermania dhe Italia, kanë import më të madh nga Ballkani, me pjesëmarrje prej 23% përkatësisht 18% nga importi i përgjithshëm në Unionin Evropian nga vendet ballkanike. Sllovenia, Hungaria dhe Kroacia gjithashtu gjenden në listën e importuesve më të mëdhenj të prodhimeve nga Ballkani Perëndimor.

## ANALIZË E KOMISIONIT EVROPIAN PËR BESIMIN E QYTETARËVE NË GJYQËSI



<http://ec.europa.eu>

Sipas analizës më të re të Komisionit Evropian (KE) nga të gjithë qytetarët të Unionit Evropian, Kroacia ka më së paku besim në gjyqësinë e vendit. Pothuajse 70% nga to konsiderojnë se ajo është e keqe, përkatësisht situatë shumë e keqe kur bëhet fjalë për paligjshmërinë e gjykatësve dhe gjykatave. Në konstatimet të KE-së të dorëzuara te Parlamenti Evropian, Këshilli Evropian dhe Këshilli i ministrave të UE-së, rreth 80% nga Danezët dhe Finlandezët, ndërsa ngjashëm edhe Austriak dhe Holandez konsiderojnë se gjyqësia e tyre është pothuajse ose tepër e pavarur.

Të ngjashëm me Kroatët për pavarësi të gjyqësisë janë Sllovenët, Bullgarët dhe Italianët, ndërsa rreth 45% të Sllovenëve besojnë se gjendja në gjykatat dhe gjykatësit, kur bëhet fjalë për pavarësinë, është shumë e keqe ose e keqe.

Në Rumani, mendimet për pavarësinë e gjykatësve dhe gjykatave janë të ndara, 45% të rumunëve konsiderojnë se pavarësia e gjyqësisë është e mirë, ndërsa numër i njëjtë

konsiderojnë se është e kërcënuar.

Vetëm 5% të qytetarëve Danez, Finlandez dhe të Luksemburgut dhe më pak se 10% të Suedezëve dhe Irlandezëve, pak më shumë Gjerman dhe Britanik konsiderojnë se pushtetet dhe politikanët kanë ndikim në pavarësinë e gjykatësve dhe gjykatave.

Analiza e dedikuar për trupat më të lartë të UE-së japin pasqyrë në "shumë të indikatorëve për atë se organizohen sistemet gjyqësore" në anëtarët të Unionit, ndërsa gjithashtu tregojnë "lloje të caktuara të situatave në të cilat është në rrezik pavarësia e gjyqësisë".

## KROACIA PLANIFIKON TË HYJË NË EUROZONËN PËR 5-7 VITE

Qeveria kroate miratoi një strategji që planifikon të futë valutën e përbashkët evropiane në 5-7 vjet.

Strategjia e re përcakton shpenzimet e transferimit të euros dhe mirëqenien ekonomike, si dhe procesin që do të pranohet, por nuk përcaktohen afate.

Kryeministri kroat Andrej Plenković, theksoi se anëtar i ri i BE-së është gati të bëjë gjithçka që duhet për të zëvendësuar kunën me euro dhe se miratimi i valitës evropiane do të jetë i mirë për vendin.

Plenković, i cili është ish-anëtar i Parlamentit Evropian, konsideron se Kroacia "ka arritur një nivel relativisht të lartë të konvergjencës" me kriteret e BE-së për kalimin në euro.

Sfida kryesore e Kroacisë është zvogëlimi i borxhit publik, i cili ra në 78% të bruto prodhimit vendor (BPV) dhe pritët të jetë 65% në vitin 2021.

Kryeministri argumenton se kjo zvogëlim tregon se qeveria e tij ndjek një "politikë ekonomike të përgjegjshme".

Parashikohet të themelohet Këshilli Nacional për kalimin në euro, i cili i përcjell kriteret kryesore makroekonomike - stabilitetin e valutës, inflacionin, përpara se të fillojë zyrtarisht

Procesi i kyçues drejtëurozonës.

Jo të gjithë janë të lumtur që Kroacia ka në plan të kalojë në eurozonë.

Sipas opozitës, futja e euros në vend të kunës nuk është në interes të Kroacisë.

Ivan Vilibor Sinčić, lider i të gjitha partive populiste, deklaroi para gazetarëve se zëvendësimi i kunës e cila është një simbol i sovranitetit kombëtar do të kishte pasoja të dëmshme ekonomike.

Megjithatë, ministrja e ekonomisë Martina Daliq theksoi se Kroacia është një "kandidate shumë e mirë" për t'u bashkuar me eurozonën dhe sugjeroi se një pjesë e madhe e kursimeve është në euro.

Ajo konfirmoi se i gjithë procesi kërkon "midis pesë dhe shtatë vjet".

Kroacia iu bashkua BE-së në 2013 dhe dëshiron të jetë një anëtar e eurozonës dhe zonës Shengen.

Polonia, Hungaria dhe Çekia nuk kanë plane për të hyrë së shpejti në eurozonë.



<http://hr.n1info.com>



### KALENDARI I BE-së / qershor 2018

1. Ngjarja evropiane e të rinjve (EYE 2018), 01-02/06/2018, Parlamenti Evropian, Strasburg;
2. Ditët evropiane të zhvillimit 2018, 05-06/06/2018, Bruksel, Belgjikë;
3. Sesioni plenar i Parlamenti Evropian, 11-14/06/2018, Strasburg;
4. Samiti i palëve të interesuara: Strategjia evropiane për inteligjencën artificiale, 18/06/2018, Bruksel, Belgjikë.

**European Union**  
Newsroom

europa.eu

EUROPA > Newsroom > Calendar

Home
Highlights >
Press releases >
Calendar >
Audiovisual
Press contacts
Press facilities >
About the EU >

### CALENDAR

**BROWSE FORTHCOMING EVENTS**

By topic

By organiser

By type

**BY MONTH**

June

Sun	Mon	Tue	Wed	Thu	Fri	Sat
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30



## KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

### BE QENDRA E KUVENDIT

Adresa: 11 tetor nr. 10, Shkup, 1000

Telefoni: +389 2 3 11 22 55 lokali 414 dhe 289

Faks: +389 2 3 182 277

E-mail: nsei@sobranie.mk

Zyra 019

---

[www.sobranie.mk](http://www.sobranie.mk)

---

*Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në periudhën janar 2011-qershor 2012 ishte zbatuar IPA Projekti për "Ndihmë teknike për Parlamentin", qëllimi i përgjithshëm i të cilës ishte përforcimi i kapacitetit institucional të Kuvendit dhe me atë përmirësim të transparencës dhe përgjegjësisë të saj para qytetarëve.*

*Në korniza të IPA projektit, ishte siguruar ndihmë financiare dhe profesionale për vendosje të BE qendrës në Kuvend.*

*Qëllimi i formimit të UE qendrës është deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe Shërbimit të Kuvendit t'u sigurohet qasje më e mirë në informata të lidhura me BE çështjet.*

*BE qendra në mënyrë organizative është në kuadër të Sektorit për mbështetje të Këshillit Nacional për Eurointegritime*

*BE qendra disponon me bibliotekë me libra dhe publikime nga sfera të ndryshme të politikave evropiane.*

